

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
KOMUNËN SHËNGJIN

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **komunën Shëngjin, njësi administrative e Bashkisë Lezhë**, me objekt: *“Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë”*, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2013 deri më 30.05.2015 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 118, datë 17.09.2015.

Bazuar në nenet mbështetje të neneve 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 549/8, datë 17.09.2015, i ka rekomanduar z. Fran Frrokaj, Kryetar i Bashkisë Lezhë e cila përfshin ish komunën Bushat si njësi administrative, zbatimin e masave të mëposhtme:

A.MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje: Nuk janë ndjekur procedurat ligjore për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm. Konkretisht, nuk kanë gjetur zbatim 3 rekomandime për shpërblim dëmi në vlerën 4,478,280 lekë nga 3 operatorë ekonomikë dhe nuk janë kontabilizuar dhe arkëtuar gjomat në vlerën 150,000 lekë, në ngarkim të 3 mbikëqyrësve të punimeve të ndërtimit.

1.1 Rekomandim: Të merren masa, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore, për arkëtimin e vlerës 4,478,280 lekë dhe arkëtimin e gjobave në vlerën 150,000 lekë.

Brenda muajit Dhjetor 2015

2. Gjetje: Në buxhetin e vitit 2015, në artikullin buxhetor 604 “Transferime të brendshme”, janë planifikuar shpenzime në forme grandi apo sponsorizimi prej 20 milion lekë, si ndihme Klubit të Futbollit “Besëlidhja”, Lezhë. Ky planifikim është kryer në shkelje të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore dhe rregullave të menaxhimit buxhetor, sepse ekipi i futbollit “Besëlidhja” nuk është Shoqëri Tregtare apo institucion publik në vartësi të Komunës Shëngjin. Konkretisht nga vlera e planifikuar prej 20 milion lekë i janë dhënë Klubit të Futbollit “Besëlidhja”, 18 milion lekë, respektivisht, me urdhër shpenzimi nr. 4, datë 26.01.2015 dhe me urdhër shpenzimi nr. 34, datë 20.02.2015.

2.1. Rekomandim: Në rastet kur Njësia Vendore nuk mbulon shpenzimet nga të ardhurat e vendore dhe deficitin kërkon ta mbulojë me grande qeveritare, të mos planifikojë në planet buxhetore vjetore shpenzime për ndihma apo sponsorizime.

Vazhdimisht

3. Gjetje: Nuk është mbajtur: ditari i veprimeve të ndryshme, libri i madh, partitarët analitikë të llogarive, si dhe nuk ka analiza të kuadruara për llogaritë e bilanceve 2013 dhe 2014. Mbyllja e llogarive dhe nxjerrja e bilancit është bërë nga jashtë bilancit. Nuk është krijuar regjistri kontabël i aktiveve që zotëron apo ka në administrim kjo Komunë. Këto veprime dhe mosveprime janë në mospajtim me ligjin Nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Po kështu, për të ardhurat nga tarifat dhe taksat vendore nuk janë kryer kontabilizime si dhe sektori i financës nuk ka bashkëpunuar me Sektorin e Tatim-Taksave për rakordimin e të ardhurave.

3.1. Rekomandim: Zyra e Financës të marrë masa dhe të organizojë mbajtjen e kontabilitetit nëpërmjet ditarit të veprimeve të ndryshme, librit të madh ose centralizatorit, të mbajë partitarët analitikë të bilancit, të krijojë regjistrin kontabël të aktiveve si dhe të punohet me Sektorin e Tatim-Taksave për rakordimin dhe kontabilizimin e të ardhurave.

Menjëherë

4. Gjetje: Në bilancin e vitit 2014, llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, paraqitet me gjendje të konsiderueshme në vlerën 33,351,534 lekë. Kjo gjendje debitorë është krijuar dhe është mbartur para vitit 2010 dhe përbehet nga 92 postesh debitorë. Pjesën më të madhe të këtij detyrimi e zë vetëm subjekti “Rafaelo 2002” me vlerë 27,347,059 lekë. Deri në fund të vitit 2014, nuk është ndërmarrë dhe nuk është bërë përpjekje për arkëtimin e këtyre detyrimeve.

4.1. Rekomandim: Njësia Vendore, Zyra e Financës të marrë masa për ndjekjen dhe arkëtimin e detyrimeve shumë 35,426,925 lekë.

Brenda muajit Dhjetor 2015

5. Gjetje: Sipas inventarit të vitit 2014, ish-Kryetari i Komunës z. L.P ka në ngarkim automjetin tip “Land Rover” me çmim 2,095,000 lekë. Ky automjet sipas deklarimeve të punonjësve të administratës ka pësuar aksident automobilistik disa vite më parë. Për këtë automjet nuk disponohet asnjë dokument teknik dhe financiar, si dhe nuk ekziston procesverbal apo ndonjë dokument tjetër nga Policia dhe nga shoqëria e sigurimeve për ngjarjen e aksidentit .

5.1. Rekomandim: Njësia Vendore të ndërmarrë masa për plotësimin e dosjes së plotë nga shoqëria e sigurimeve, me dokumentacion teknik dhe financiar dhe me dokumentacionin që vërteton aksidentin e këtij mjeti dhe të ndjekë procedurat ligjore për nxjerrjen e përgjegjësive dhe vlerësimin e gjendjes së automjetit (riparimin, nxjerrjen jashtë përdorimit apo shitjen për skrap).

Brenda muajit Tetor 2015

6. Gjetje: Komuna Shëngjin, për periudhën objekt auditimi (01.01.2013 deri më 30.05.2015), ka realizuar ***gjithsej 8 procedura prokurimi me fond limit të përgjithshëm 71,716,598 lekë, dhe ka lidhur po 8 kontrata me vlerë 70,669,518 lekë.*** U konstatua:

Në procedurat për “Blerje karburanti” për vitin 2013 me fond limit 4,881,856 lekë, për vitin 2014 me fond limit 5,760,000 lekë dhe për vitin 2015 me fond limit 6,054,999 lekë, KVO-të kanë vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, në procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, sepse kanë bërë vlerësim fiktiv dhe subjektiv të ofertave të operatorëve pjesëmarrës dhe në veçanti të ofertës ekonomike të operatorit fitues. Kjo shkelje ndikon edhe gjatë zbatimit të kontratës, sepse Autoriteti Kontraktor në mungesë të marzhit të fitimit të shprehur vetëm në vlerë absolute, nuk mund të kontrollojë përqindjen e rritjes apo të uljes së çmimit të bursës, e shprehur kjo qartësisht në rregullat e prokurimit publik .

6.1. Rekomandim: Për çdo procedurë prokurimi për blerje karburante, KVO-të të vlerësojnë ofertat e operatorëve në bazë të çmimeve të botuara në buletin e fundit të APP-së para hapjes së ofertave, të marra nga bursa Reuters.

Vazhdimisht

7.. Gjetje: Procedura e prokurimit për “Blerje karburanti” për vitin 2014 me fond limit 5,760,000 lekë, është zhvilluar me “negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”. Përzgjedhja e kësaj procedure është bërë me arsyetimin dhe argumentimin se: *“Këshilli Komunës nuk ka marrë vendim për miratimin e buxhetit të vitit 2014”*. Ky veprim bie në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, të cilat përcaktojnë qartësisht se kjo procedure mund të përdoret në rastet: *“e nevojës ekstreme, të shkaktuar nga ngjarje të paparashikueshme nga autoriteti kontraktor”* .

7.1. Rekomandim: Në rast të mos miratimit nga Këshilli i Njesisë të Qeverisjes Vendore të buxhetit vendor, të gjitha procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe punë, të zhvillohen me vlerë të plotë, duke respektuar kufijtë monetare dhe pa tejkaluar shpenzimet faktike që janë kryer në vitin e mëparshëm për çdo objekt prokurimi.

Vazhdimisht

8. Gjetje: Në procedurën e prokurimit “Investim në fshatin Ishull-Lezhe“, me fond limit 41,878,762 lekë të realizuar në vitin 2014, kanë marrë pjese 2 operatore ekonomikë. Është kualifikuar operatori “F...”, me ofertën ekonomike në vlerën 34,305,350 lekë dhe është s’kualifikuar operatori “S...”, me ofertën ekonomike në vlerën 29,833,985 lekë. KVO, në vazhdim të vlerësimit, pas 20 ditësh. Anulimi i këtij tenderi është në kundërshtim të hapur me nenin 24, të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin Publik”.

8.1. Rekomandim: Autoriteti Kontraktor, në ato raste kur procedura e prokurimit anulohet për shkak të veprimeve apo mosveprimeve të autoritetit Kontraktor apo për mungesën e konkurrencës, duhet të analizojë arsyet e dështimit të procedurës dhe të nxjerri përgjegjësit dhe të korrigjojë dokumentet e tenderit në mënyrë të tillë që të sigurojë konkurrencën në procedurat e prokurimit.

Vazhdimisht

9. Gjetje: Për vitin 2015, sasia e karburantit prej 35,000 litra është tërhequr me tollona menjëherë që me lidhjen e kontratës, si dhe është likuiduar në total e gjithë vlera e kontratës. Tërheqja dhe likuidimi i gjithë sasisë së karburantit që me lidhjen e kontratës, të pashoqëruara me të dhëna të botuara në buletin e APP-së, e bën të pa mundur kontrollin e përqindjes së rritjes apo të uljes së çmimit të bursës sipas Reuters, livruar sipas kushtit CIF-Shqipëri dhe kontrollin e cilësisë së mallit të livruar, nëse është e njëjtë me atë të premtuar në ofertë, siç përcaktojnë rregullat e prokurimit publik .

9.1. Rekomandim: Gjatë zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant para pagimit të faturës, të kontrollohet rritja apo ulja e çmimit të bursës sipas buletinit të APP-së, si dhe të kontrollohet cilësia e mallit të lëvruar, nëse është e njëjtë me atë të premtuar në ofertë.

Vazhdimisht

10. Gjetje: Për vitet 2013, 2014 dhe deri në maj 2015, nuk janë ndjekur procedurat ligjore për arkëtimin e të ardhurave vendore nga 48 subjektet debitorë në vlerën **totale 10,021,249 lekë**, në kundërshtim me ligjin Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”.

10.1. Rekomandim: Zyra e Taksave e Tarifave Vendore në bashkëpunim me zyrën e Financës dhe Zyrën Juridike, të ndjekin të gjitha procedurat ligjore, për arkëtimin e plotë të detyrimeve të subjekteve debitorë me **vlerë 10,021,249 lekë**.

Brenda muajit Mars 2016

11. Gjetje: Për vitet 2013, 2014 dhe 2015, të ardhurat nga taksat: e pasurisë, e pastrimit, e gjelbërimit dhe e ndriçimit për popullatën, janë planifikuar nga Zyra e Tatim Taksave me rezerva të konsiderueshme, sepse nga të dhënat e marra në Zyrën e Gjendjes Civile dhe të krahasuara ato me të dhënat që disponon Zyra e Tatim Taksave, rezultojnë diferenca ndërmjet tyre. Nga llogaritjet e këtyre diferencave del se janë planifikuar më pak të ardhura që do përfitoheshin nga këto taksa rreth **12,508,460 lekë**, veprim ky në kundërshtim me nenin 12, nenin 20 dhe nenin 21, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”

11.1. Rekomandim: Për çdo vit buxhetor, Zyra e Taksave e Tarifave Vendore, të planifikojë të ardhurat bazuar në numrin e familjeve sipas të dhënave që ka Zyra e Gjendjes Civile.

Brenda muajit Mars 2016

12. Gjetje: Për vitet 2013, 2014 dhe 2015, nga Zyra Taksave e Tarifave Vendore nuk është planifikuar vjelja e taksës së tokës bujqësore, për të gjithë sipërfaqen e tokës bujqësore që ka në juridiksion Komuna, sepse, nga të dhënat e marra nga Zyra e Mbrojtjes dhe Menaxhimit të Tokës në Komunë dhe të krahasuara ato me të dhënat që disponon Zyra Taksave e Tarifave Vendore, rezultojnë diferenca ndërmjet sipërfaqeve tyre. Vlera e pa planifikuar e kësaj takse llogaritet rreth 2,512,000 lekë. Po kështu, kjo zyrë nuk ka ndjekur procedurat ligjore për arkëtim të taksës së tokës bujqësore për familjet debitorë në vlerën 11,490,000 lekë, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 8982, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave vendore”.

12.1. Rekomandim: Për çdo vit buxhetor, vlera e taksës së tokës bujqësore të planifikohet në bazë të të dhënave të marra nga Zyra e Mbrojtjes dhe Menaxhimit të Tokës në Njësinë Vendore, si dhe Zyra e Taksave e Tarifave Vendore të ndjekë procedurat ligjore për arkëtimin e detyrimeve të taksës së tokës bujqësore për familjet debitorë në vlerën **11,490,000 lekë**.

Brenda muajit Mars 2016

13. Gjetje: Nga Zyra e Taksave e Tarifave Vendore nuk janë kryer verifikime, bllokime dhe sekuestrime për aktivitetin tregtar që kryejnë 38 subjekte të cilat janë evidentuar të pa regjistruara në QKR, në kundërshtim me nenet 17 dhe 19, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”. Vlera e të ardhurave të munguara si pasojë e mospagimit nga këto subjekte llogaritet në shumën **1,037,868 lekë**

13.1 Rekomandim: Zyra e Taksave e Tarifave Vendore, të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për regjistrimin e 38 subjekteve në QKR dhe për arkëtimin e detyrimeve në vlerën **1,037,868 lekë**.

Brenda muajit Dhjetor 2015

14. Gjetje: U konstatuan veprime në kundërshtim me ligjin Nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, sepse disa subjekte të regjistruara të cilat kanë ushtruar aktivitet gjatët vitit 2013 kanë paguar taksat vendore të këtij viti, ndërsa për vitin 2014 nuk i kanë paguar këto taksa. Mirëpo nga të dhënat e QKR, këto subjekte nuk janë çregjistruar si dhe nuk rezultojnë me statusin pasiv, por rezultojnë madje edhe sot me statusin aktiv. Nga llogaritjet tona, vlera e taksave dhe tatimeve vendore që nuk kanë paguar këto subjekte për vitin 2014 llogaritet rreth **1,188,000 lekë**.

14.1. Rekomandim: Zyra e Taksave e Tarifave Vendore, të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për evidentimin e këtyre subjekteve dhe arkëtimin e taksave vendore në shumën **1,188,000 lekë**.

Brenda muajit Dhjetor 2015

15. Gjetje: Në të gjitha rastet e miratimit të lejeve të zhvillim/ndërtimit për sipërfaqet pronësisë së tokës, në të cilat do të zhvillohej ndërtimi, nuk është kërkuar ndryshimi i zërit kadastral nga tokë arë në tokë truall, si dhe nuk disponohet dokumenti i bonitetit të tokës.

15.1. Rekomandim: Për të gjitha rastet e miratimit të lejeve të zhvillim/ndërtimit, për sipërfaqet e pronësisë së tokës, në të cilat do të zhvillohet ndërtimi, të kërkohej ndryshimi i zërit kadastral nga tokë arë në tokë truall, si dhe në çdo dosje të disponohet dokumenti i bonitetit të tokës.

Vazhdimisht

16. Gjetje: Të gjitha kërkesat e aplikantëve për kryerje punimesh **nuk janë protokolluar në protokollin e Komunës**, por janë dorëzuar nga aplikantët dorazi në Këshillin Teknik, pra nuk dihet nëse është respektuar apo jo afati i miratimit apo i refuzimit prej 45 ditë pune nga paraqitja e kërkesës, veprim ky në mospërputhje me rregullat e planifikimit dhe kontrollit të territorit. Po kështu, dokumentacioni që ndodhet në dosjet e këtyre lejeve zhvillim ndërtimit, është i pa inventarizuar për çdo fletë, si dhe nuk është hartuar fletë inventari për dokumentacionin përkatës, veprim në mospërputhje me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

17.1. Rekomandim: Të gjitha kërkesat e aplikantëve për marrje leje zhvillimi /ndërtimi për kryerje punimesh, të dorëzohen fillimisht në protokollin e Komunës, ku të vendoset nr. protokollin dhe më pas të përcillen për shqyrtim në Këshillin Teknik.

Vazhdimisht

17.2. Rekomandim: Të gjithë praktikantët e lejeve të zhvillim /ndërtimit të inventarizohen sipas kërkesave të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

Brenda muajit Tetor 2015

18. Gjetje: Për periudhën objekt i këtij auditimi, janë dhënë gjithsej 30 leje përdorimi për objekte në pronë private, të cilat janë dërguar për regjistrim në ZVRPP Lezhë. Dokumentacioni që ndodhet në dosje është i pa inventarizuar. Disa dosje nuk janë plotësuar me kërkesat për leje përdorimi nga subjekti ndërtues, me procesverbalet nga OSSHE, me vërtetimet nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve për shlyerjen e detyrimeve tatimore, me certifikatat e provave laboratorike të materialeve të përdorura dhe me relacionet sizmike (*Trajtuar më hollësisht në faqet 100-103, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

18.1. Rekomandim: Të gjitha dosjet e lejeve të përdorimit të inventarizohen sipas kërkesave të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

Menjëherë

19. Gjetje: Me VKM nr. 504, datë 19.07.2006 dhe Nr. 682, datë 26.09.2012 “Për miratimin e listës së inventarëve të pronave të paluajtshme shtetërore, në Komunën Shëngjin, të Qarkut Lezhë”, janë transferuar gjithsej 362 prona shtetërore. Mos ngritja dhe mos funksionimi i këtij sektori është në kundërshtim me VKM-në Nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin dhe transferimin e pronave të paluajtshme” dhe me Udhëzimin nr. 15, datë 30.06.2003 të Ministrisë së Pushtetit Vendor e Decentralizimit.

19.1. Rekomandim: Në strukturën e Njesisë Vendore të ngrihet dhe të funksionojë Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, në përputhje me VKM-në nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin dhe transferimin e pronave të paluajtshme”.

Brenda muajit Tetor 2015

20. Gjetje: Nisur nga mungesa e një strukture të posaçme për menaxhimin e pronave dhe nga vonesat e tej zgjatura të regjistrimit nga ZVRPP, Njësia Vendore duhej të ngrinte grupe pune dhe të bashkëpunonte me institucionet që i kanë pasur këto prona në inventar për të bërë dhe për të mundësuar, mbledhjen e dokumentacionit me qëllim vlerësimin dhe inventarizimin paraprak dhe me pas regjistrimin në kontabilitetin e Njesisë Vendore të pronave të transferuara, në zbatim të pikës 22, të VKM-se nr. 500 datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të Paluajtshme Shtetërore dhe Transferimin e Pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore”.

20.1. Rekomandim: Të ngrihen grupe pune për të plotësuar me dokumentacionin e mjaftueshëm e të nevojshëm pronat e transferuara nga institucionet që i kanë pasur në inventar ato, me qëllim vlerësimin paraprak të tyre dhe regjistrimet në kontabilitet.

Menjëherë

21. Gjetje: U konstatua se, disa prona të transferuara kësaj njësie vendore që para vitit 2013 janë të zëna apo të zaptuar nga të tretet, dhe kjo njësi vendore nuk ka bërë përpjekje për lirim të tyre. Po kështu nuk ka negociuar për lidhje kontrate qiraje me këto subjekte private që cilët shfrytëzojnë këto pasuri publike padrejtësisht. Duke ju referuar, përcaktimeve të VKM Nr. 529, datë 08.06.2011 dhe VKM Nr. 54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, vlera minimale e qirasë e pa arkëtuar nga shfrytëzimi i këtyre sipërfaqeve të zëna padrejtësisht

llogaritet rreth **3,127,050 lekë** (kjo llogaritje është bere vetëm për periudhën objekt auditimi janar 2013- maj 2015, pa llogaritur periudhën që nga transferimi i pronave.

21.1. Rekomandim: Të merren masa për lirimin e pronave publike që shfrytëzohen padrejtësisht nga subjektet privat. Në pamundësi të mundësohet lidhja e kontratave të qiradhënies duke përllogaritur detyrimet që rrjedhin shfrytëzimi i kësaj prone publike që nga hyrja në fuqi e VKM^{ve} nr. 504, datë 19.07.2006 dhe Nr. 682, datë 26.09.2012 “Për miratimin e listës së inventarëve të pronave të paluajtshme shtetërore, në Komunën Shëngjin, të Qarkut Lezhë”.

Brenda muajit Dhjetor 2015

22. Gjetje: Nga Inspektorati i Mbrojtjes dhe Kontrollit të Territorit Vendor (IKMTV), në 9 raste nuk janë arkëtuar gjoba në vlerën 2,840,691 lekë, e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e komunës, veprim në mospërputhje me nenin 15, të ligjit Nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar, si dhe nuk janë llogaritur kamatë-vonesat për mos likuidim në afat të gjobës në vlerën 1,704,415 lekë, veprime në kundërshtim me ligjin Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” .

22.1. Rekomandim: Të merren masa për nxjerrjen e urdhër kontabilizimit, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës **4,454,106 lekë**, nga e cila; vlera 2,840,691 lekë gjoba nga ndërtimet e paligjshme dhe vlera 1,704,415 lekë kamat vonesë nga mos likuidimi të gjobës.

Brenda muajit Dhjetor 2015

23. Gjetje: Nga Inspektorati i Mbrojtjes dhe Kontrollit të Territorit Vendor (IKMTV), aktet e nxjerra nuk janë botuar në regjistrin e territorit apo mjete të tjera të informimit, veprim në mospërputhje pikën 4, të nenit 81, të ligjit Nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”, i ndryshuar .

23.1. Rekomandim: Për çdo rast aktet e nxjerra nga Inspektorati i Mbrojtjes dhe Kontrollit të Territorit Vendor, të botohen në regjistrin e territorit apo në mjete të tjera te informimit.

Vazhdimisht

24. Gjetje: Me urdhër të Kryetarit të Komunës, është emëruar në detyrën e Kryeinspektorit z. P. K me profesion Jurist, emërim ky në kundërshtim me kërkesat e nenit 11, të ligjit Nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për Inspektimin e Ndërtimit”.

24.1. Rekomandim: Në pozicionin e Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes dhe Kontrollit të Territorit Vendor, të vendoset një punonjësi i arsimuar në fushën e ndërtimit, siç përcaktohet dhe në dispozitat ligjore, pasi punonjësi aktual është diplomuar për Jurist.

Menjëherë

25. Gjetje: Nga Inspektorati i Mbrojtjes dhe Kontrollit të Territorit Vendor (IKMTV), në zbatim të nenit 12, të ligjit Nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e ndërtimit”, janë mbajtur gjithsej 57 procesverbale konstatimi për ndërtime pa leje. Nga 57 procesverbale konstatimi, nuk kanë vijuar procedurat e mëtejshme ligjore për 8 raste, duke marrë si vlerë minimale 300,000 lekë secili, në total vlera 2,400,000 lekë .

25.1. Rekomandim: Të merren masa për penalizmin e 8 subjekteve të cilat kanë ndërtuar pa leje ndërtimi në vlerën minimale 300,000 lekë secili, gjithsej 2,400,000 lekë, si dhe të ndiqen procedurat ligjore në zbatim të germës “dh”, të nenit 5, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar dhe me pikat 1 e 2, të nenit 81, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”, i ndryshuar.

Brenda muajit Nëntor 2015

26. Gjetje: Emërimi i punonjësve të Policisë Komunale është bërë në kundërshtim me nenin 4, të ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997, si dhe me Urdhrin e Përbashkët të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 1530, datë 07.04.2003 dhe Ministrit të Rendit Publik, nr. 823, datë 11.04.2003 .

26.1. Rekomandim: Të zbatohen të gjitha procedurat ligjore për emërimin e punonjësve të Policisë se Njesisë Vendore sipas kërkesave të ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997.

Brenda muajit Tetor 2015

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në ligjin nr. 8485, date 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, kreu I, nenet 105-109 dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave, nr. 30, date 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitet e Sektorit Publik Kap IV, -Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, nga ana e Titullarit të Njesisë Publike, (Nëpunësi

Autorizues), të nxirën aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat nevojshme administrative dhe procedurat e tjera , në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjeke procesin dhe të kryhej regjistrimet nevojshme kontabël përfundimtare me qëllim **shpërblimin e dëmit në vlerën 35,321,520 lekë, si me poshtë:**

1. Gjetje: Janë paguar punonjës mbi strukturën e miratuar me vendim të KK dhe konfirmuar nga Prefekti Qarkut Lezhë, nga e cila; për vitin 2013 paguar 1 punonjës administrate, 40 punonjës të mirëmbajtjes dhe 39 punonjës sezonalë dhe për vitin 2014 janë paguar 23 punonjës në administratë, 53 punonjës të mirëmbajtjes dhe 8 punonjës sezonalë. Si rezultat i këtyre shtesave të bërë në muaj të ndryshëm, janë paguar punonjës më tepër se organika e miratuar, duke i shkaktuar buxhetit të Komunës dëm ekonomik në vlerën **4,410,454 lekë**. Ky veprim bie në kundërshtim me VKK, nr. 2, datë 31.01.2013, me VKK, nr. 5, datë 11.02.2015, me ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisje vendore”, me ligjin nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “ Për Buxhetin e vitit 2013” dhe me aktet nënligjore ne zbatim te këtyre ligjeve.

1.1. Rekomandim: Bashkia Lezhë, ku bën pjesë njësia administrative Shëngjin, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë ndaj punonjësve shkaktarë përgjegjës dhe të bëjë kontabilizimet e nevojshme, duke ndjekur procedurat ligjore, për arkëtimin e vlerës prej **4,410,454 lekë**, nga punonjësit përgjegjës.

Brenda muajit Dhjetor 2015

2. Gjetje: Në 3 raste me vlerë 112,791 lekë, janë kryer pagesa në kundërshtim me VKM Nr. 1619, datë 02/07/2008 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e Njësive të Qeverisjes Vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të Qeverisjes Vendore”, i ndryshuar. Kjo, sepse paga e grupit për të cilën janë paguar nuk përputhet me nivelin arsimor të tyre. Po kështu dhe klasifikimi nuk është sipas pozicionit, konkretisht disa punonjës të cilët nuk janë me arsimin përkatës janë paguar sipas kategorisë III-b, por në fakt duheshin paguar me kategori IV-a .

2.1. Rekomandim: Bashkia Lezhë, ku bën pjesë njësia administrative Shëngjin, të marrë masa, për nxjerrjen e urdhër kontabilizimit, si dhe të ndjeke të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e pagës në vlerën **44,978 lekë**, të përfituar padrejtësisht nga punonjësja znj. B.P, arkëtimin e pagës në vlerën **35,071 lekë** të përfituar padrejtësisht nga punonjësi z. F.H dhe arkëtimin e pagës në vlerën **32,742 lekë**, të përfituar padrejtësisht nga punonjësi z. S.H.

Brenda muajit Tetor 2015

3. Gjetje: Në 2 raste me vlerë **34,800 lekë**, në muajt mars dhe korrik 2014 janë paguar me pagë për lejet e zakonshme, veprime këto në kundërshtim me VKM Nr. 463, datë 16.06.2011 "Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore", i ndryshuar .

3.1. Rekomandim: Bashkia Lezhë, ku bën pjesë njësia administrative Shëngjin, të marrë masa, për nxjerrjen e urdhër kontabilizimit, si dhe të ndjeke të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e pagës për lejet e zakonshme të përfituar padrejtësisht në vlerën **34,800 lekë** nga punonjësit z. I.M.

Brenda muajit Tetor 2015

4. Gjetje: Me burim financimi nga fondi rezervë dhe i kontigjencës, së buxhetit vendor të vitit 2013 dhe 5-mujorit të vitit 2015, është dhënë ndihmë ekonomike për 94 persona privatë në shumën e përgjithshme 3,110,000 lekë. Ky financim është bërë kryesisht për familjet me gjendje të vështirë ekonomike, për sëmundje, për fatkeqësi natyrore, etj. Këto shpenzime janë kryer me miratim të Këshillit Komunal, por në çdo rast dokumenti i pagesës në favor të personave përfitues nuk është shoqëruar me dokumentin identifikues, me dokumente që të vërtetojnë gjendjen e rëndë ekonomike të familjeve, me raportet mjekësore për të sëmuret, me vendime të organeve të KEMP-ve, me proces-verbale për dëmet natyrore të shkaktuara, etj, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

4.1. Rekomandim: Bashkia Lezhë, ku bën pjesë njësia administrative Shëngjin, të marrë masa, për plotësimin me dokumentacionin justifikues të çdo përfituesi. Në të kundërt, në pamundësi të mbledhjes së këtij dokumentacioni, të ndiqen procedurat ligjore për arkëtimin e shumës **3,110,000 lekë**, nga personat përfitues.

Brenda muajit Tetor 2015

5. Gjetje: Janë kryer shpenzime për blerje kartash të telefonisë celulare, në shumën 360,000 lekë. Këto shpenzime i kanë përfituar padrejtësisht në kundërshtim me VKM Nr. 864, datë 23.7.2010, “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë, publikë”, Kryetari i Këshillit z. E.L, në vlerën 180,000 lekë, Nën/Kryetari i Këshillit z.K.N në vlerën 60,000 lekë dhe Sekretari i Këshillit z. E.P, në vlerën 120,000 lekë”.

5.1. Rekomandim: Bashkia Lezhë, ku bën pjesë njësia administrative Shëngjin, të marrë masa dhe të nxirret urdhër kontabilizimi, duke ndjekur procedura ligjore për arkëtimin e shumës **360,000 lekë**, nga punonjësit përfitues.

Brenda muajit Tetor 2015

6. Gjetje: Kryetari i Komunës ka përfituar padrejtësisht bonus financiar mujor për shërbimin e transportit në vlerën 45,000 lekë, për periudhën janar-mars 2014, në kundërshtim me nenin 2, të ligjit Nr. 10160, datë 15.10.2009, i ndryshuar, me nenin 1, të ligjit Nr. 169/2013 Për disa ndryshime në ligjin nr. 10160, datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publik dhe nëpunësit civil”.

6.1. Rekomandim: Bashkia Lezhë, ku bën pjesë njësia administrative Shëngjin, të marrë masa dhe të nxirret urdhër kontabilizimi, duke ndjekur procedura ligjore për arkëtimin e shumës **45,000 lekë** nga punonjësi përfitues.

Brenda muajit Tetor 2015

7. Gjetje: Nga Zyra e Financës, për vitin 2014, janë paguar penalitete në vlerën 23,726 lekë për mos pagesë në kohë të detyrimeve për sigurimet shoqërore dhe tatimin mbi pagë, veprime në kundërshtim me ligjin Nr. 9146, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, i ndryshuar.

7.1. Rekomandim: Bashkia Lezhë, ku bën pjesë njësia administrative Shëngjin, të marrë masa dhe të nxirret urdhër kontabilizimi, duke ndjekur procedura ligjore për arkëtimin e shumës **23,726 lekë** nga përgjegjësi i Zyrës së Financës z. M.Z.

Brenda muajit Tetor 2015

8. Gjetje: Në procedurat e prokurimeve me vlera të vogla, të realizuara në vitin 2014, në disa raste u konstatuan shkelje me dëm ekonomik në **vlerën totale 896,820 lekë**, konkretisht:

-Në procedurën e prokurimit për blerje çakulli nga subjektin “M.....”, është shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 349,200 lekë, sepse çmimi i çakullit është përcaktuar në fondin limit dhe në faturën e furnizimit më i lartë se, çmimi i përcaktuar në manualin teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit.

-Në procedurën e prokurimit për riparimin e kazanëve të mbeturinave nga subjektin “L....” është shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 432,000 lekë, sepse gjatë zbatimit të punimeve për riparimin e kazanëve rezultoi se, janë riparuar më pak 20 kazanë në një kohë që vlera e riparimit të tyre prej 432,000 lekë është përfituar padrejtësisht nga subjekti “L....”.

8.1. Rekomandim: Bashkia Lezhë, ku bën pjesë njësia administrative Shëngjin, të marrë masa dhe të kryej kontabilizimin, duke ndjekur procedura ligjore për arkëtimin e shumës **896,820 lekë**, nga personat përgjegjës, respektivisht;

-**vlera 61,714 lekë**, nga z. M.Z me detyrë përgjegjës i zyrës së financës, për shkeljen e procedurave në likuidimin e shpenzimeve të kryera në riparimin e koshave të mbeturinave (blerje me vlera të vogla);

-**vlera 87,300 lekë**, nga z. Gj. Gj me detyrë përgjegjës i zyrës së shërbimeve, për mangësitë e konstatuara në mos argumentimin me dokumentacion ligjorë të shpenzimeve të kryera për riparimin e rrugëve me çakull;

-**vlera 115,620 lekë**, nga z. B.K me detyrë përgjegjës i zyrës Planifikim dhe Zhvillim Territorit, për mangësitë e konstatuara në planifikimin e fondit limit të prokurimit me vlera të vogla të artikull “blerje tombino”;

-**vlera 149,014 lekë**, nga znj. E.M me cilësinë e kryetarit të komisionit të blerjeve të vogla, për mangësitë e konstatuara në blerjet me vlera të vogla për artikullin “çakëll për shtrim rruge” dhe shpenzime për “riparim kazan mbeturinash”;

-**vlera 149,014 lekë**, nga z. E.L me cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve me vlera të vogla, për mangësitë e konstatuara në blerjet me vlera të vogla për artikullin “çakëll për shtrim rruge” dhe shpenzime për “riparim kazan mbeturinash”;

-vlera 149,014 lekë, nga z. R.N me cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve të vogla, për mangësitë e konstatuara në blerjet me vlera të vogla për artikullin “çakëll për shtrim rruge” dhe shpenzime për “riparim kazan mbeturinash”;

-vlera 61,714 lekë, nga z. P.V me cilësinë e anëtarit të komisionit të mbikëqyrjes së riparimit të koshave të mbeturinave urbane (urdhri nr. 53/1, dt. 03.09.2014), për mangësi në dokumentacionin ligjorë të shpenzimeve të kryera për riparimin e koshave të mbeturinave;

-vlera 61,714 lekë, nga z. F.S me cilësinë e anëtarit të komisionit të mbikëqyrjes së riparimit të koshave të mbeturinave urbane (urdhri nr. 53/1, dt. 03.09.2014), për mangësi në dokumentacionin ligjorë të shpenzimeve të kryera për riparimin e koshave të mbeturinave;

-vlera 61,714 lekë, nga z. F.T me cilësinë e anëtarit të komisionit të mbikëqyrjes së riparimit të koshave të mbeturinave urbane (urdhri nr. 53/1, dt. 03.09.2014), për mangësi në dokumentacionin ligjorë të shpenzimeve të kryera për riparimin e koshave të mbeturinave;

Brenda muajit Tetor 2015

9. Gjetje: Sipërfaqja e dhënë në përdorim të plazheve për vendosje çadra, janë trajtuar si hapësirë publike, dhe nuk janë trajtuar si prona publike të njësisë. Nga ky veprim vlera e shfrytëzimit të sipërfaqeve për plazhe janë llogaritur në zbatim të ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar në vend që të llogariteshin sipas përcaktimeve të VKM Nr. 529 datë 08.06.2011, i ndryshuar me VKM Nr. 54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”. Nga llogaritjet tona del një diferencë e konsiderueshme nga aplikimi i vlerave si hapësirë publike me vlerat minimale të qerave të përcaktuara në VKM e mësipërme. Konkretisht diferenca e pa arkëtuar llogaritet në vlerën rreth **6,949,339 lekë**, e ndare kjo për vitin 2013 në vlerën 3,398,924 lekë dhe në vitin 2014 në vlerën 3,550,415 lekë.

9.1. Rekomandim: Bashkia Lezhë, ku bën pjesë njësi administrative Shëngjin, të marrë për evidentimin e subjekteve të cilat shfrytëzojnë hapësira publike për vendosje çadra plazhit dhe të nxirren njoftim vlerësimet për arkëtimin e vlerën **6,949,339 lekë**, në përputhje me përcaktimet e VKM Nr. 529 datë 08.06.2011, i ndryshuar me VKM Nr. 54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”.

Brenda muajit Mars 2015

10. Gjetje: Për objektet e reja të pajisur me leje përdorimi, nga zyra e tatim taksave për këto objekte nuk ka planifikuar dhe nuk ka arkëtuar taksën e pasurisë si për objektet me destinacion banimi ashtu edhe për objektet tregtare. Kjo taksë nga llogaritjet tona del e pa arkëtuar në vlerën totale **7,820,402 lekë**. Ky veprim është në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, dhe me VKK-të: nr. 57 datë 21.12.2012, nr. 5 datë 24.03.2014 dhe nr. 4 datë 11.02.2015.

10.1. Rekomandim: Bashkia Lezhë, ku bën pjesë njësi administrative Shëngjin, të marrë masa nëpërmjet Zyrës së Tatim Taksave, duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës **7,820,402 lekë**, nga subjektet e pajisur me leje përdorimi si për popullatën dhe për aktivitete tregtare.

Brenda muajit Dhjetor 2015

11. Gjetje: Është llogaritur më pak, në vlerën totale **1,364,250 lekë** taksa e pasurisë për 92 subjekte tregtare, sepse nuk është taksuar e gjithë sipërfaqja faktike e ndërtesave prej 9,095 m² duke e ndryshuar atë nga viti në vit, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” dhe me VKK-në nr. 57 datë 21.12.2012, nr. 5 datë 24.03.2014 dhe me nr. 4 datë 11.02.2015.

11.1. Rekomandim: Bashkia Lezhë, ku bën pjesë njësi administrative Shëngjin, të marrë masa nëpërmjet Zyrës së Tatim Taksave, duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës **1,364,250 lekë**, nga subjektet tregtare të cilat kanë paguar këtë taksë me pak se sipërfaqet faktike.

Brenda muajit Dhjetor 2015

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 58 “Llojet e masave disiplinore” dhe nenin 59 “Kompetencat dhe procedurat për masat disiplinore” të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 171, datë 26.3.2014 “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të

nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Lezhë:

Të vlerësojë, në varësi të analizës së përgjegjësive, shkallën e përgjegjësisë për mangësitë dhe shkeljet për secilin punonjës të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe të filloi procedurat për dhënien e masave disiplinore:

A. “Largim nga puna”, për:

1. Z. M.Z, me detyrë Përgjegjësit të Zyrës së Financës:

Ky punonjës gjatë periudhës objekt auditimi, ka vepruar në kundërshtim, me bazën ligjore dhe nënligjore që rregullon fushën e: Buxhetit, Kontabilitetit, Administrimit të vlerave Monetare e Materiale dhe Menaxhimit financiar dhe Kontrollit dhe fushën që rregullon marrëdhëniet e punës dhe të pagave të punonjësve të organeve të Qeverisjes Vendore. Po kështu me cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në procedurat e prokurimit: “Blerje Karburanti për vitin 2013”, me fond limit 4,068,213 lekë, “Ndërtimi i Murit Rrethues të Kopshtit të Fëmijëve, Shëngjin”, me fond limit 1,398,642 lekë të realizuar në vitin 2013, “Investim në fshatin Ishull-Lezhë” me fond limit 34,898,969 lekë të realizuar në vitin 2014, “Blerje Karburanti për vitin 2014”, me fond limit 4,800,000 lekë dhe “Blerje Karburanti për vitin 2015” me fond limit 5,045,833 lekë, ka vepruar në kundërshtim, me bazën ligjore dhe nënligjore që rregullon fushën e Prokurimit Publik.

2. Z. B.K, me detyrë Përgjegjës i Zyrës së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit:

Ky punonjës, gjatë periudhës objekt auditimi, ka miratuar disa leje zhvillimore dhe leje përdorimi në kundërshtim me bazën ligjore dhe nënligjore që rregullon fushën e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit si dhe ka vepruar në kundërshtim, me bazën ligjore dhe nënligjore që rregullon fushën administrimit dhe menaxhimit të pronave të paluajtshme shtetërore dhe të transferimit të pronave në njësitë e qeverisjes vendore. Po kështu, me cilësinë e Anëtarit të Njesisë së Prokurimit, në procedurat e prokurimit: “Investim në fshatin Ishull-Lezhë” me fond limit 34,898,969 lekë të realizuar në vitin 2014, dhe “Blerje Karburanti për vitin 2014” me fond limit 4,800,000 lekë, ka vepruar në kundërshtim, me bazën ligjore dhe nënligjore që rregullon fushën e Prokurimit Publik.

3. Z. P.K, me detyrë Përgjegjësit të Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Vendor:

Ky punonjës, ka vepruar në kundërshtim, me bazën ligjore dhe nënligjore që rregullon fushën e Kontrollit dhe të Disiplinimit të Ndërtimeve dhe të Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit. Po kështu me cilësinë e Anëtarit të Njesisë së Prokurimit, në procedurat e prokurimit: “Investim në fshatin Ishull-Lezhë”, me fond limit 34,898,969 lekë të realizuar në vitin 2014 dhe “Blerje Karburanti për vitin 2014” me fond limit 4,800,000 lekë, ka vepruar në kundërshtim, me bazën ligjore dhe nënligjore që rregullon fushën e Prokurimit Publik.

4. Z. Z.M, me detyrë Përgjegjës i Zyrës së Tatimit Taksave Vendore:

5. Z. E.P, me detyrë inspektor në Zyrën e Tatimit Taksave Vendore:

6. Z. I.M, me detyrë Inspektor i Zyrës së Tatimit Taksave Vendore:

Këta punonjës, ka vepruar në kundërshtim me bazën ligjore dhe nënligjore që rregullon fushën e të ardhurave nga taksat dhe tarifa vendore. Konkretisht: nuk ka planifikuar të ardhurat nga taksa e bizneset dhe të ardhurat nga tarifa e tokës bujqësore nga familjalet në vlerën totale 22,998,460 lekë, nuk ka ndjekur procedurat ligjore për 48 subjektet debitorë në vlerën 10,021,249 lekë, ka llogaritur më pak taksën e pasurisë për 92 subjekte tregtare në vlerën totale 1,364,250 lekë, nuk ka ndjekur arkëtuar taksën e pasurisë për objekte tregtare të ndërtuara dhe të pajisura me leje përdorimi në vlerën totale 7,820,402 lekë. Po kështu, nuk ka ndjekur procedurat ligjore për çregjistrimin e subjekteve në QKR, si dhe nuk ka ndjekur procedurat ligjore për subjekte që janë evidentuar të pa regjistruara në QKR.

B. “Vërejtje” për:

1. Z. K.N, me detyrë ish-Nen/Kryetar Komune:

Ky punonjës, me cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në procedurën e prokurimit “Blerje Karburanti për vitin 2013” me fond limit 4,068,213 lekë, ka vepruar në kundërshtim, me bazën ligjore dhe nënligjore që rregullon fushën e Prokurimit Publik.

2. Z. V.Gj, me detyrë ish-Nen/Kryetar Komune:

Ky punonjës me cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në procedurën e prokurimit “Blerje Karburanti për vitin 2013” me fond limit 4,068,213 lekë, ka vepruar në kundërshtim, me bazën ligjore dhe nënligjore që rregullon fushën e Prokurimit Publik. PO

kështu me detyrën e ish-ZV/Kryetarit të Komunës, ka vepruar në kundërshtim, me bazën ligjore dhe nënligjore që rregullon fushën administrimit dhe menaxhimit të pronave të paluajtshme shtetërore dhe të transferimit të pronave në njësitë e qeverisjes vendore.

3. z. A.Gj, me detyrë Përgjegjës i Burimeve Njerëzore:

Ky punonjës me cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në procedurat e prokurimit: “Ndërtimi i Murit Rrethues të Kopshtit të Fëmijëve, Shëngjin”, me fond limit 1,398,642 lekë të realizuar në vitin 2013 dhe “Investim në fshatin Ishull-Lezhe”, me fond limit 34,898,969 lekë të realizuar në vitin 2014, ka vepruar në kundërshtim, me bazën ligjore dhe nënligjore që rregullon fushën e Prokurimit Publik.

4. Znj. E.B, me detyrë specialiste në Zyrën Juridike:

Kjo punonjëse me cilësinë e Anëtares së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në procedurën e prokurimit “Investim në fshatin Ishull-Lezhe” me fond limit 34,898,969 lekë të realizuar në vitin 2014, ka vepruar në kundërshtim, me bazën ligjore dhe nënligjore që rregullon fushën e Prokurimit Publik.

5. Z. P.L me detyrë, specialist në Zyrën e Turizmit:

Ky punonjëse me cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në procedurën e prokurimit “Investim në fshatin Ishull-Lezhe”, me fond limit 34,898,969 lekë të realizuar në vitin 2014, ka vepruar në kundërshtim, me bazën ligjore dhe nënligjore që rregullon fushën e Prokurimit Publik.

6. Znj. A.S, me detyrë Nen/Kryetare e Komunes:

Kjo punonjëse me cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në procedurën e prokurimit “Blerje Karburanti për vitin 2014” me fond limit 4,800,000 lekë, ka vepruar në kundërshtim, me bazën ligjore dhe nënligjore që rregullon fushën e Prokurimit Publik.

7. Z. I.D, me detyrë specialiste në Inspektoratin Ndërtimor e Urbanistik Vendor:

Ky punonjës me cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në procedurën e prokurimit “Blerje Karburanti për vitin 2014”, me fond limit 4,800,000 lekë, ka vepruar në kundërshtim, me bazën ligjore dhe nënligjore që rregullon fushën e Prokurimit Publik.

8. Z. I.M, me detyrë Kryeinspektor i Policisë së Komunës:

Ky punonjës, ka vepruar në kundërshtim me bazën ligjore dhe nënligjore që rregullon fushën e funksionimit të Policisë Komunale për shkelje të konstatuar nga Policia e Komunës.

9. Z. Sh.H, me detyrë me detyrë Përgjegjës i Zyrës së Kadastrës dhe Shërbimit Pyjor:

Ky punonjës, ka vepruar në kundërshtim me bazën ligjore dhe nënligjore që rregullon fushën e Administrimit dhe Menaxhimit të Tokës.

10. Z. D.M, me detyrë me detyrë Përgjegjës i Zyrës së Kadastrës dhe Shërbimit Pyjor:

Ky punonjës, ka vepruar në kundërshtim me bazën ligjore dhe nënligjore që rregullon fushën e Administrimit dhe Menaxhimit të Tokës.

11. Z. Kujtim Kaloshi, me detyrë ish-Përgjegjës në Zyrën e Kadastrës dhe Shërbimit Pyjor:

Ky punonjës, ka vepruar në kundërshtim me bazën ligjore dhe nënligjore që rregullon fushën e Administrimit dhe Menaxhimit të Aseteve.

12. Z. Gj.Gj, me detyrë Përgjegjës i Zyrës së Shërbimeve:

Ky punonjës, ka vepruar në kundërshtim me bazën ligjore dhe nënligjore që rregullon fushën administrimit dhe menaxhimit të pronave të paluajtshme shtetërore dhe të transferimit të pronave në njësitë e qeverisjes vendore. Po kështu me cilësinë përgjegjësit të ndjekjes së punimeve për shtrimin e rrugëve me çakull dhe plotësimin e dokumentacionit justifikues për likuidimin e mallit, ka vepruar në kundërshtim, me bazën ligjore dhe nënligjore që rregullon fushën disiplinimi dhe kontrollit të punimeve dhe menaxhimit financiar dhe kontrollit.

13. Z. P.V, me detyrë specialist në Zyrën e Shërbimeve:

Ky punonjës, me cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Mbikëqyrjes së Punimeve dhe marrjes në dorëzim të koshave të mbeturinave urbane të riparuar, ka vepruar në kundërshtim, me bazën ligjore dhe nënligjore që rregullon fushën menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të menaxhimit të aktiveve në njësitë e sektorit publik.

14. Z. F.S, me detyrë inspektor në Zyrën e Kadastrës dhe Shërbimit Pyjor:

Ky punonjës me cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Mbikëqyrjes së Punimeve dhe marrjes në dorëzim të koshave të mbeturinave urbane të riparuar, ka vepruar në kundërshtim, me bazën ligjore dhe nënligjore që rregullon fushën menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të menaxhimit të aktiveve në njësitë e sektorit publik.

15. Znj. E.M, me detyrë Përgjegjëse e Zyrës së Turizmit:

16. Z. E.L, me detyrë përgjegjës i Zyrës së Protokoll/Arshivës:

17. Z. R.N, me detyrë specialist në Zyrën e Ndihmës Ekonomike:

Këta punonjës, me cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Prokurimit me “blerje të vogla”, në procedurat e prokurimit: “ blerje çakulli”, “blerje kosha mbeturinash” dhe “riparim kazan mbeturinash”, të realizuara në vitin 2014, ka vepruar në kundërshtim, me bazën ligjore dhe nënligjore që rregullon fushën e Prokurimit Publik.

Nga Bashkia Lezhë, është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë pranuar dhe janë në process vlerësimi e zbatimi.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit shtetëror Bashkim Harizi, Kristaq Gjurgjaj, Hysen Metko, Aleksander Papadhimitri dhe Luan Kuka, më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT